Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT I MONITORIMIT TË KOMUNAVE

Korrik – Shtator 2010

Përmbajtja

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës
Aktet komunale
Ligjshmëria e akteve
Transparenca
Konflikti i interesit

Hyrje

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës të Republikës së Kosovës është rregulluar statusi juridik i komunave dhe funksionimi i qeverisjes Lokale. Komunat, si njësi themelore të Vetëqeverisjes Lokale, kanë një shkallë të lartë të autonomisë lokale, konform Kartës Evropiane për Vetërqeverisje Lokale, të garantuar me Kushtetutë dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Në bazë të mandatit që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, obligohet të mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimeve që ndërmerr komuna, në mënyrë që ato të mos bien ndesh me LVL-në, ligje të tjera dhe të mos cenojnë të drejtat e qytetarëve. Me qëllim të mbështetjes së komunave gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, MAPL, gjegjësisht Divizioni i Monitorimit në kuadër të Departamentit për Vetëqeverisje Lokale, vazhdimisht monitoron seancat e kuvendeve komunale dhe Departamenti Ligjor analizon ligjshmërinë e akteve që janë nxjerr nga Kuvendi Komunal apo Kryetari i Komunës.

Në përputhje me detyrimin ligjor të MAPL-së për monitorimin e aktivitetit të Komunave, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale ka monitoruar aktivitetet e kuvendeve të komunae dhe në vazhdën e hartimit të raporteve periodike, ka hartuar dhe raportin e monitorimit për periudhën e tre mujorit të tretë të vitit 2010.

Në raport janë përfshirë të dhëna të përgjithshme rreth funksionimit të organeve komunale, duke përfshirë funksionimin e ekzekutivit dhe kuvendet komunale.

Dokumenti është hartuar në pjesë të ndara, duke përfshirë nga katër ose pesë komuna në grupe. Kjo ndarje është bërë në pajtim me numrin e komunave që monitorojnë zyrtarët përgjegjës të monitorimit të Ministrisë.

Në kuadër të raportit, përfshihen të dhëna për 34 komuna të Republikës së Kosovës. Komunat e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk janë përfshirë në raport në mungesë të informatave dhe pamundësisë praktike të zyrtarëve tanë për monitorim.

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal, përmes këtij raporti paraqet një pasqyrë të përgjithshme të komunave në kontekst të zbatimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale, por edhe ligjeve të tjera në fuqi për periudhën kohore korrik – shtator 2010.

Në këtë raport është nënvizuar se komunat e Republikës së Kosovës kanë vazhduar të shënojnë progres dhe situata e përgjithshme është më e mirë se në periudhën e kaluar raportuese. Kjo është shumë inkurajuese. Ky raport i monitorimit nuk synon që të sjell të gjitha rezultatet e arritura, por në fokus ka që të evidentojë procedurat dhe përmbatjet e akteve komunale në dritën e legjislacionit në fuqi. Prandaj në këtë raport janë prezantuar raste , kur organet e komunës kanë pasur vështirësi në implementimin e kuadrit ligjor, që ka ndikuar në zvarritjen e realizimit të disa aktiviteteve dhe të cilat janë manifestuar edhe gjatë punës së Kuvendeve Komunale. Sipas raportit, vështirësitë janë shfaqur gjatë procedurave të miratimit të akteve nga kuvendet komunale, duke mos ndjekur drejt procedurat që kërkohen me ligjet ne fuqi. Kjo situatë e ka detyruar për veprim Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal duke kthyer për rishqyrtim disa nga aktet e miratuara në kuvend.

Ka pasur raste kur në mungesë të pajtimit politik komunat kanë dështuar që të zbatojnë ndonjë provizion ligjor që është i obliguar për autoritetet komunale. Pra, është evidentuar nevoja për një përparim të theksuar nga perspektiva politike në mënyrë që Kuvendet Komunale të arrijnë pajtim për të miratuar një numër të rëndësishëm të akteve komunale që nuk ka ndodhur kryesisht në mungesë të votave të mjaftueshme në seancat e Kuvendeve. Kjo ka ndikuar që forcimi i demokracisë të mbetët ende i dëshiruar dhe mungesa e akteve komunale në disa raste ka vonuar implementimin e projekteve të ndryshme. Kjo është pika strategjike ku komunat duhet të jenë të kujdesshme dhe të forcojnë progresin. Rastet më specifike kanë qenë ato të Rahovecit dhe Prizrenit të cilat është kanë pasur nevojë të zgjidhen përmes Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Komunat duhet të forcojnë bashkëpunimin me organet mbikëqyrëse administrative. Realizimi i kuadrit ligjor në këtë pikë mbetet ende i dëshiruar. Përkundër faktit që janë miratuar shumë rregullore komunale ato në disa raste nuk janë sjellë tek organet mbikëqyrëse administrative për të konkluduar pajtimin ligjor siç kërkohet me provizionet ligjore.

Komunat kanë shënuar progres edhe në miratimin e propozim buxhetit 2011 dhe planifikimeve strategjike të buxhetit për vitet 2012-2013. Megjithatë, disa nga komunat kanë dështuar që të miratojnë propozim buxhetin dhe në alternativë kanë miratuar kornizën afatmesme buxhetore, duke mos vepruar plotësisht

konform qarkores buxhetore të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, me të cilën obligon komunat që jo më larg se më 30 shtator 2010 të dorëzojnë propozim buxhetet për vitin 2011.

Pasqyrim i përgjithshëm

Komunat: Dragash, Prizren, Suharekë, Mamushë
Kodi: 03

Ky raport përqendrohet në disa prej aktiviteteve kryesore të Kuvendeve të këtyre Komunave. Në përgjithësi, ecuria e funksionimit të këtyre kuvendeve për periudhën e raportimit ka qenë e rregullt, ndërkohë që në një numër të vogël të rasteve janë evidentuar disa parregullsi.

Gjatë periudhës korrik-shtator 2010, Kuvendet Komunale kanë mbajtur gjithsej 11 mbledhje.

Në Komunën e Suharekës janë mbajtur 2 mbledhje, në Komunën e Prizrenit janë mbajtur 3, në Komunën e Dragashit 4 mbledhje si dhe në Komunën e Mamushës janë mbajtur 2 mbledhje.

Në përgjithësi, këto komuna kanë respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve për seancat, të cilat në shumicën e rasteve kanë filluar dhe janë zhvilluar në përputhje më rendin e ditës.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendet e këtyre Komunave, në përputhje me obligimet e tyre kanë miratuar një numër aktesh, si vendime dhe rregullore. Në total kemi të nxjerra 5 Rregullore dhe 39 vendime.

Në përputhje me qarkoren e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, këto komuna kanë miratuar propozim buxhetet komunale për vitin 2011 brenda afatit ligjor, si dhe projeksionet buxhetore për vitet 2012 - 2013.

Pas konstituimit të kuvendeve komunale, zyrtarët e monitorimit në përputhje me kërkesat ligjore për shmangie të konfliktit të interesit, kanë marrë informacione të nevojshme për anëtarët e Kuvendit, të cilët eventualisht mbajnë pozita të dyfishta. Sipas zyrtarëve përgjegjës në këto komuna, tanimë nuk ka raste të mbajtjes së pozitave të dyfishta.

Sa i përket konflikteve tjera të interesit, siç është p.sh me rastin e vendimmarrjes, është paraqitur një rast kur një anëtar i Kuvendit të Suharekës ka paraqitur konfliktin e interesit dhe është përmbajtur nga procesi i votimit.

Gjetjet më të rëndësishme

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar si shkelje ligjore në Komunën e Dragashit dhe Komunën e Prizrenit. Kurse në Komunat Suharekë dhe Mamushë nuk janë evidentuar raste të tilla.

Nga zyrtarët monitorues të MAPL-së janë evidentuar shkelje në disa raste në aspektin e mospërmbushjes procedurale të disa obligimeve ligjore në Komunën e Dragashit dhe Prizrenit.

Në rastin e Komunës së Prizrenit, bazuar në vendimin e gjykatës kushtetuese, në lidhje me emblemën komunale, Kuvendi i Komunës ka dështuar në miratimin e emblemës së re, sipas kërkesës së Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, Komuna e Prizrenit, nuk ka arritur të përmushë obligimin ligjor ashtu siç parashihet me nenin 43.3 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, duke mos respektuar afatin e paraparë për njoftim paraprak me shkrim, ashtu siç kërkohet shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së seancave të rregullta[1]. Me këtë rast, pas ndërhyrjes së MAPL-së, Komuna ka arritur të përsërisë të njëjtën mbledhje dhe të veprojë konform dispozitave ligjore dhe rekomandimeve të MAPL-së.

Në njërën nga seancat e radhës së Komunës së Dragashit është evidentuar shkelje në lidhje me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, duke mos respektuar obligimin ligjor që kërkohet se përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e etnive politike në Kuvendin e Komunës. MAPL i është drejtuar me shkresë zyrtare kësaj komune, dhe me këtë rast ka konstatuar se vendimi i nxjerrë ishtë në kundërshtim me nenin 40 të Statutit të Komunës së Dragashit dhe nenin 52.1 të LVL-së.

[1] MAPL përmes shkresës 07-279/8 të datës 23-07-2010, ka kthyer për rishqyrtim vendimet e miratuara në mënyrë të kundërligjshme në seancën e dates 08.07.2010. Komuna e Prizrenit në seancën e radhës të datës 30.08.201 ka vepruar konform udhëzimeve të MAPL-së

Komunat: Gjakovë, Junik, Deçan, Rahovec

Kodi: 02

Pasqyrim i përgjithshëm

Raporti përqendrohet në disa nga aktivitetet kryesore të Kuvendeve të komunave të Gjakovës, Junikut, Deçanit dhe Rahovecit. Në përgjithësi, aktivitetet e këtyre komunave janë konform rregullave dhe legjislacionit, përjashtimisht disa vendimeve të cilat nuk kanë qenë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi.

Kuvendet e komunave: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec, kanë mbajtur gjithsej 9 mbledhje.

Me përjashtim të Komunës së Deçanit e cila jo në të gjitha rastet ka dërguar me kohë ftesën për mbledhje, komunat tjera kanë përmbushur me kohë këtë obligim. Mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, e disa nga to kanë transmetuar dhe vazhdojnë të transmetojnë direkt mbledhjet në medie lokale.

Mbledhjet kryesisht kanë filluar me kohë dhe rrjedha e seancës zhvillohej në përputhje me pikat e rendit të ditës. Në këto komuna nuk ka pasur raste të ankesave nga anëtarët e kuvendeve për sa i përket kohës së dërgimit të materialeve.

Në këto komuna kanë qenë funksionale edhe Komitetet e obligueshme.

Në këtë periudhë, komunat kanë përgatitur dhe miratuar Draft-Buxhetin për vitin 2011 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2012-2013.

Gjatë periudhës korrik-qershor janë evidentuar shkelje në Komnunën e Rahovecit dhe Deçanit, ndërsa në komunën e Junikut dhe të Gjakovës, nuk kemi evidentuar ndonjë rast të shkeljeve ligjore.

Janë miratuar akte me rëndësi, siç janë: miratimi dhe ndryshimi i Statutit[2], Rregullore të ndryshme mbi bazën e të cilave mundësohet funksionimi efikas i komunës dhe akte të tjera të nevojshme.

Gjatë kësaj periudhe nuk është paraqitur ndonjë rast që ka të bëjë me mbajtje të pozitave të dyfishta. Tanimë kjo praktikë pamundësohet edhe me U.A. Nr.

[2] Ndryshimi dhe miratimi i Statutit të Komunës së Junikut

01/2010 për kufizimet e kompensimit dhe marrjes së pagës nga zyrtarët e komunave.

Gjetjet më të rëndësishme

Në Komunën e Rahovecit gjatë periudhës korrik-shtator,2010, ekzekutivi ka hasur në pengesa të caktuara.me rastin e paraqitjes së dorëheqejes nga kryetari i Komunës. MAPL kishte reaguar konform mandatit të vet ligjor, ndërkaq me interpretimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Komuna e Rahovecit do të shkojë në zgjedhje të parakohshme, data e të cilave tashmë është caktuar.

Ndërsa, Komuna e Deçanit ka themeluar dy drejtori tjera, pa ndërmarrë veprimet paraprake për ndryshimin e statutit të Komunës. Gjithashtu, në Kuvendin e Komunës së Deçanit nuk është miratuar propozim-buxheti për vitin 2011.

Komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit, Shtërpcë
Kodi: 06

Pasqyrim i përgjithshëm

Raporti për punën tremujore të Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Shtimes, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit është hartuar mbi bazën e monitorimit të seancave të kuvendeve të komunave dhe analizimit të dokumenteve të ndryshme dhe procesverbaleve të mbledhjeve.

Kuvendet e këtyre komunave kanë funksionuar normalisht duke përfshirë këtu edhe funksionimin e komiteteteve obligative.

Sa i përket njoftimit për mbledhjet e kuvendit, këto komuna i kanë dërguar ftesat dhe materialet me kohë në MAPL, ashtu siç parashihet më Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur gjithsej 12 mbledhje.
Kuvendi i Komunës së Ferizajt gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 seanca. Janë miratuar 9 vendime dhe një rregullore.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur dy seanca. Janë miratuar 7 vendime dhe një rregullore. Është miratuar Rregullorja për përdorimin e gjuhëve.

Gjatë kësaj periudhe nuk është evidentuar ndonjë konflikt interesi nga ana e anëtarëve të kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur dy mbledhje. Janë miratuar 6 vendime dhe 2 rregullore. Kuvendi ka miratuar edhe shumë kërkesa të ardhura nga qytetarët.
Ndërsa është evidentuar një rast ku vullnetarisht kryesuesi ka deklaruar konfliktin e interesit dhe me rastin e votimit është tërhequer nga salla.

Kuvendi Komunës së Hanit të Elezit gjatë këtij tre mujor ka mbajtur dy seanca. Janë miratuar 10 vendime, njëherit ka marrë vendim që Projektrregulloren për gjuhët ta kaloj në diskutim publik.

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka mbajt 3 seanca . Gjatë këtyre seancave janë miratuar 5 rregullore dhe 7 vendime.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka miratuar Statutin e Komunës, simbolet, Rregulloren për transparencë si dhe Rregulloren për përdorimin e gjuhëve.

Gjatë kësaj periudhe këto komuna kanë mbajtur edhe tubime publike me qytetarë.

Kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar propozimbuxhetin për vitin 2011 si dhe projeksionet buxhetore 2011-2013, siç kërkohet me qarkoren buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Nuk ka pas ndonjë konflikt interesi gjatë kësaj periudhe nga ana e anëtareve të kuvendit.

Gjetjet më të rëndësishme

Sa i përket evidentimit të shkeljeve ligjore, zyrtarët e monitorimit kanë evidentuar një rast si shkelje ligjore. Me këtë rast, Kuvendi ka marrë vendim për ndërtimin e vendbanimit të ri në fshatin Brod, lagja "Smajlaj", pronë e cila është në menaxhimin e AKP-së.

Në komunën e Ferizajt, është zgjedhur zëvendëskryesuesi i kuvendit nga radha e komunitetit shumicë, pozitë e cila nuk parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Komunat: Pejë, Klinë, Istog, Malishevë
Kodi: 05

Pasqyrim i përgjithshëm

Ky raport ka për qëllim të pasqyrojë gjendjen reale gjatë periudhës korrik-shtator 2010 në lidhje me funksionimin dhe aktivitetet e këtyre komunave: Pejë, Klinë, Istog dhe Malishevë.

Kuvendet e Komunave Pejë, Klinë, Istogu dhe Malishevë gjatë periudhës korrik-shtator 2010 kanë mbajtur gjithsej 11 mbledhje.. Me përjashtim të Komunës së Malishevës, në përgjithësi komunat e lartcekura kanë dërguar me kohë ftesën për mbledhje, por ka edhe raste të tilla kur ftesat për mbledhje kanë arritur me vonesë.

Gjithashtu, në këto Komuna janë funksionale edhe Komitetet obligative. Këtu duhet përjashtuar Komitetin për Komunitete në Komunën e Malishevës, i cili nuk ka mbajtur akoma asnjë mbledhje.

Komuna e Malishevës gjatë periudhës së raportimit ka themeluar edhe Komitetin për Arsim dhe Kulturë.

Për tre-mujorin e tretë të këtij viti, Komuna e Istogut dhe e Malishevës ka organizuar një tubim publik me qytetarët, ndërsa Komuna e Klinës ka mbajtur dy tubime.

Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë periudhës së raportimit ka miratuar nëntë (9) Vendime, Kuvendi i Komunës së Istogut ka miratuar katër (4) vendime dhe një (1) Rregullore, Kuvendi i Komunës së Klinës ka miratuar tetë (8) vendime dhe Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar pesë (5) vendime dhe një Rregullore.[3]

Në këtë periudhë, komunat po ashtu kanë përgatitur dhe miratuar projektbuxhetin për vitin 2011.

[3] Aktet e miratuara gjatë kësaj periudhe, janë të elaboruara më gjerësisht në Monitorin e akteve komunale të publikuar nga MAPL

Gjetjet më të rëndësishme

Gjatë periudhës, së raportimit Komuna e Malishevës nuk , ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit, si dhe për aktivitetet e tjera të organeve komunale, ashtu sic parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. [4]

Ndërsa në Komunën e Pejës vazhdojnë të mbahen pozita të cilat nuk parashihen me Ligjin për vetëqeverisje lokale, siç është rasti me nënkryetarin e tretë të Komunës.

[4] Për këtë çështje Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka dërguar disa herë shkresë në këtë Komunë.

Komunat: Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë
Kodi: 01

Pasqyrim i përgjithshëm

Ky raport pasqyron gjendjen reale të funksionimit dhe aktivitetit të kuvendeve të Komunave; Prishtinë, Obiliqi, Lipjani, Podujevë dhe Fushë-Kosovë

Gjatë këtij tre mujori Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Obiliqit, Podujevës, Lipjanit, Fushë-Kosovës, kanë mbajtur gjithsej 15 mbledhje. Ftesat për mbledhje nga këto komuna dërgohen me kohë si anëtarëve të kuvendit poashtu edhe MAPL-së, ashtu siç parashihet me nenin 43 të LVL-së.

Të gjitha këto mbledhje kanë qenë transparente. Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka marrë pjesë ekzekutivi i komunës.

Sa i përket propozimit të buxhetit për vitin 2011, të gjitha komunat kanë mbajtur takime publike me qytetarë, ashtu siç obligohen me Ligjin për financat publike. Këto komuna kanë përgatitur dhe miratuar propozimbuxhetin për vitin 2011, në përputhje me qarkoren buxhetore 2011/01 të cilën e ka dërguar Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Komitetet obligative në këto komuna, edhe në këtë periudhë kanë qenë funksionale.

Gjatë kësaj periudhe, janë miratuar akte të ndryshme dhe me rëndësi për komunat. Kuvendi i Komunës së Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka miratuar 10 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së e Fushë-Kosovës 9 vendime dhe 1 rregullore, Lipjani 5 vendime dhe 2 rregullore, Obiliqi 22 vendime dhe 2 rregullore, Podujeva 6 vendime dhe 2 rregullore[5].

Sa i përket konfliktit të interesit, përveç komunës së Lipjanit, nuk është evidentuar ndonjë rast gjatë kësaj periudhe. Në Komunën e Lipjanit drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër ende vazhdon të mbaj dy pozita, atë të anëtarit të Kuvendit dhe të drejtorit.
MAPL, duke marrë parasysh U.A 01/2010 për kufizimet e kompensimit dhe marrjes së pagës nga zyrtarët e komunave, ka kërkuar nga ai që të jap dorëheqje nga njëra pozitë.

[5] Kuvendi i Komunës së Podujevës ka miratuar Rregulloren për përdorim të gjuhëve dhe Rregulloren për transparencë

Gjetjet më të rëndësishme

Në komunën e Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31.08.2010 është evidentuar një shkelje dhe atë lidhur me vendimin me rastin e shitjes së banesave shërbyesve civil në " Kompleksin 300" në Fushë – Kosovë.
Ky vendim bazohet në Rregulloren për shitjen e banesave e cila rregullore nuk është dërguar në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë[6].

Poashtu, gjatë kësaj periudhe MAPL në bashkëpunim me MAP-in në bazë të Udhëzimit Administrativ 01/2010 për kufizimet e kompensimit dhe marrjes së pagës nga zyrtarët e komunave, ka arritur që të bëjë ndalesën e kompensimit dhe marrjes së pagës të njërit nga nënkryetarët e Komunës së Lipjanit.
Kryetari i komunës më parë ka emëruar 2 nënkryetarë nga komuniteti shumicë, gjë që është në kundërshtim me neni 60 të LVL-së.

[6] Kjo çështje është duke u shqyrtuar në Departamentin Ligjor të MAPL-së

Komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë.
Kodi: 04

Pasqyrim i përgjithshëm

Raporti paraqet aktivitetet kryesore për periudhën korrik-shtator, 2010 për komunat: Gjilani, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë.

Kuvendet e këtyre komunave dhe komitetet obligative, kanë funksionuar normalisht.
Sa i përket njoftimit për mbledhjet e kuvendeve, këto komuna gjatë këtij tremujori, nuk kanë përmbushur si duhet këtë detyrim ligjor .

Në këtë periudhe, kuvendet e komunave kanë mbajtur gjithsej 9 seanca.

Gjatë kësaj periudhe, nuk është evidentuar ndonjë shkelje ligjore në këto Komuna.

Komunat: Vushtrri, Mitrovicë, Skenderaj, Gllogoc

Kodi 04

Pasqyrim i përgjithshëm

Gjatë periudhës korrik- shtator 2010, Kuvendet e Komunave: **Vushtrri, Mitrovicë, Skenderaj, Gllogoc kanë mbajtur** gjithsej 8 mbledhje, që do të thotë se secila prej tyre ka mbajtur nga 2 mbledhje.

Gjatë kësaj periudhe të gjitha ftesat u janë dërguar me kohë anëtarëve të kuvendit, e gjithashtu edhe MAPL-së, me përjashtim të Komunës së Gllogocit, që si ftesat e ashtu edhe materialet nuk i kanë dërguar në MAPL.

Mbledhjet rregullisht kanë qenë të hapura për publikun. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe komitetet e obligueshme kanë qenë funksionale.

Në seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe, kuvendet komunale kanë miratuar këto vendime dhe rregullore: Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në dy seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe kohore, ka miratuar gjithsej 12 vendime dhe 2 rregullore; Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në dy seancat e mbajtura ka miratuar 9 vendime dhe 2 rregullore; Kuvendi i Komunës së Skenderajt në dy seancat e mbajtura ka miratuar 8 vendime dhe 1 rregullore; dhe Kuvendi i Komunës së Gllogocit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 2 mbledhje, në të cilat janë miratuar 3 vendime dhe 2 rregullore.

Në përputhje me qarkoren buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të gjitha komunat kanë miratuar propozim buxhetet komunale për vitin 2011 brenda afatit ligjor, si dhe projeksionet buxhetore për vitet 2012 - 2013.

Zyrtarët e monitorimit në përputhje me kërkesat ligjore për shmangie të konfliktit të interesit, kanë marrë informacione të nevojshme nëse anëtarët e kuvendit eventualisht mbajnë pozita të dyfishta. Sipas zyrtarëve përgjegjës në këto komuna, nuk ka raste të mbajtjes së pozitave të dyfishta.

Gjatë periudhës raportuese, nuk janë evidentuar shkelje ligjore nga këto Komuna, me përjashtim të komunës së Gllogocit që nuk e ka dërguar me kohë ftesën dhe materialin për mbledhje të Kuvendit, ashtu sic parashihet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Komunat : Gracanica, Ranilluk, Kllokot dhe Partesh .
Kodi

Pasqyrim i përgjithshëm

Kuvendet Komunave të reja: Graçanicë, Ranillug, Kllokot dhe Partesh funksionojnë normalisht. Në këto komuna kanë funksionuar edhe Komitetet obligative, duke mbajtur takime të rregullta.

Mbledhjet e kuvendeve janë transparente.

Sa i përket njoftimit për mbledhje, këto komuna (përveç Komunës së Kllokotit) i dërgojnë ftesat më kohë ashtu siç parashihet më Ligjin për vetëqeverisje lokale. Me qëllim të forcimit të transparencës dhe bashkëpunimit, janë organizuar tubime publike me qytetarë. Ka pasur raste që gjatë seancës anëtarët e kuvendeve janë ankuar se atyre nuk u janë dërguar materialet të kompletuara.

Gjatë kësaj periudhe tre mujore kuvendet e komunave Graçanicës, Ranillug, Kllokot dhe Partesh kanë mbajtur gjithsej 9 seanca dhe nga këto janë monitoruar 4 seanca nga MAPL.

Kuvendi Komunal i Graçanicës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 4 seanca. Në këto seanca janë miratuar 3 vendime dhe një rregullore.

Kuvendi Komunës së Ranillugut ka mbajtur 2 seanca. Janë miratuar 2 rregullore: Rregullorja për Punën e Kuvendit dhe Rregullorja për Transparencë. Ndërsa, janë miratuar 2 vendime.

Gjatë kësaj periudhe është bërë inaugurimi i Kuvendit të Komunës së Parteshit. Gjatë këtij tre mujori janë mbajtur 3 seanca. Është miratuar Rregullorja për Punën e Kuvendit dhe 9 vendime.

Gjatë kësaj periudhe kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar propozim buxhetin komunal për vitin 2011 si dhe projeksionet buxhetore 2011- 2013, në përputhje me qarkoren buxhetore të lëshuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa. Gjithashtu janë mbajtur edhe takimet publike në lidhje me propozim buxhetin ashtu siç parashihet me Ligjin për Financat Publike.

Konkluzione

- Komunat kanë rritur angazhimin dhe marr veprimet e nevojshme për implementimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duke shënuar progres në shumë fusha.

- Disa komuna nuk kanë dërguar me kohë ftesën dhe materialet për mbledhje ashtu sic e parasheh neni 43.5 i LVL-së.

- Shumica e komunave kanë përgatitur propozim buxhetin për vitin 2011 si dhe projeksionet buxhetore për vitin 2012-2013 dhe ky proces në shumicën absolute të rasteve është bërë sipas procedurave përkatëse ligjore dhe të parimit të konsultimit e transparencës.

- Komunat kanë rritur interesimin e tyre që të implementojnë rekomandimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2010, edhe pse vazhdojnë të mbeten evidente një numër i kufizimeve i rasteve që autoritetet komunale nuk kanë marrur veprimet e nevojshme për realzimin e tyre.

- Në disa raste vazhdon të jetë evidente mbajtja e pozitave të dyfishta nga zyrtarët komunal duke shkaktuar konflikt interesi.

- Janë evidentuar raste të shkeljeve procedurale dhe ligjore me rastin e miratimit ë vendimeve në kuvend.

- Komunat kanë miratuar Rregulloret e kërkuara në përputhje me detyrimet ligjore.

Rekomandime

- Rekomandojmë komunat që t'i dërgojnë me kohë ftesën për mbajtje të mbledhjeve së bashku me materialet e kompletuara, ashtu siç parashihet me nenin 43.5 të LVL-së.

- Rekomandojmë komunat që të veprojnë në përputhje me ligjet dhe aktet tjera nënligjore.

- Rekomandojmë komunat që të ndërmarrin masa konkrete ndaj zyrtarëve të cilët vazhdojnë të mbajnë pozita të dyfishta.

- Rekomandojmë që të bëhen plotësim-ndryshimet e Statuteve komunale, konform organizimeve të tyre të brendshme dhe në përputhje me LVL-në dhe Ligjin për Kufijtë Administrativ.

- Rekomandojmë komunat që para marrjes së vendimeve të konsultohen me organin mbikëqyrës (MAPL-në) dhe të respektojnë procedurat paraprake që kërkohen në mënyrë që të evitohen gabimet eventuale nga perspektiva ligjore.